



RAPORT PERFUNDIMTAR
AUDITIMI
MBI
Auditimin Financiar
(Tematik)

“BASHKIA PUKË”



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE
USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

Tiranë 2019

I	Përmbajtje	Faqe
I/a	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4 - 4
I/b	PËRSHKRIM I PËRMBLEDHUR GJETJE E REKOMANDIME.....	4 - 7
II.	HYRJA.....	7 - 13
<i>a.</i>	<i>Objektivat dhe qëllimi</i>	
<i>b.</i>	<i>Identifikimi i çështjes</i>	
<i>c.</i>	<i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</i>	
<i>d.</i>	<i>Përgjegjësitë e Audituesve</i>	
<i>e.</i>	<i>Kriteret e vlerësimit</i>	
<i>f.</i>	<i>Standardet e auditimit</i>	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	13 - 14
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMIT.....	14 - 62
A.	<i>Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016), ligjin nr.130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”, dhe ligjin nr.109/2017, datë 30.11.2017“Për buxhetin e shtetit të vitit 2018”, me ndryshimet.....</i>	14 - 27
B.	<i>Vlerësimi i Raportimit Financiar, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht në, udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njërive që varen prej tyre si dhe të njërive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”;</i>	27- 62
V.	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT.....	62 - 67
VI.	DOKUMENTACIONI SHOQËRUES dhe ANEKSE.....	67 - 69



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

I/a. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Pukë në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 557/1 prot, datë 13.08.2019, dhe afat auditimi nga data 03.06.2019 deri në datën 09.08.2019, për periudhën nga 01.01.2018 deri më 31.12.2019.

Auditimi u krye për pasqyrat financiare të vitit 2018, mbi bazë materialitetit dhe risku si dhe gjendja aktuale lidhur me planifikimin dhe zbatimin e buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, hartimi i pasqyrave financiare, si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullave të institucionit dhe parimeve për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Pukë dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimit me thesarin, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 202- *Studime dhe kërkime*; 210 “*Toka, Troje, Terrene*”; 211 “*Pyje, Plantacione*”, 212 “*Ndërtesa Konstruksione*”; 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”; 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” 215 “*Mjete Transporti*” në vlerën 24,649,367 lekë; 218 “*Inventar Ekonomik*”; 31 “*Materiale*”; 32 “*Inventari i imet*” 401-408-*Furnitorë e llogari te lidhura me to*; 467-*Kreditorë te ndryshëm*; 468 “*Debitorë të ndryshëm*”; 466 “*Mjete në ruajtje*”; 602-*shpenzime operative*; 219 *Ëmptizimi i aktiveve*; 230- 231-*investime etj.*

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 2 akte të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të auditimit brenda afatit të periudhës së auditimit datë 06.09.2019.

Në hartimin e projektraport auditimit, grupi i KLSH nuk ka marrë në konsideratë kundërshtitë e subjekti, pasi projektraport auditimi, është dërguar subjekti, pa mbaruar afatin 7 ditorëi përgjigjes. Sqarojmë se kundërshtitë e paraqitura gjatë kësaj faze dhe fazës së projektraport auditimit, do lexohen me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizim nga ana e grupit të auditimit të KLSH, gjatë fazës së përgatitjes së Raportit Përfundimtar të Auditimit, dhe për rastet që kanë argumentim do merren në konsideratë, ndërsa rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentin e duhur ligjorë, do gjejnë pasqyrim në Raportin Përfundimtar Auditimi, i cili do ti përcillet subjekti për njohje dhe marrjen e masave për përmisimin e gjendjes.

I/b. NJË PËRSHKRIM I PËRMBLEDHUR I GJETJEVE DHE REKOMANDIMEVE NGA AUDITIMI.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësi	Rekomandimi
1.	KLSH ka konstatuar se në vitin ushtrimor 2018 gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) ta klasës 21 është në vlerën 3.766.275.808 lekë, e cila është e plotë, pasi janë pasqyruar në mënyrë të sintetizuar të gjitha shtesat dhe pakësimet, Nga verifikimi i inventareve kontabël rezultoi se janë azhornuar	44-46	mesën	Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Pukë të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktivesh sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim,



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE
USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësi	Rekomandimi
	<p><u>bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas amërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.</u> Për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo rregjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. <i>(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr.5 të Projekt Raportit</i></p>			<p>përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.</p>
2.	<p>2. KLSH ka konstatuar se nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura për kryerje investimesh për vlerë të plotë të kontratës, <u>as në momentin e mbërritjes së faturave.</u> Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur ndërhyjnë pagesa. Kështu nuk janë bërë regjistrimet kontabël në llog.231 “Shpenzime për investime për aktive afatgjata materiale” për 7 kontrata në vlerën 272,952,444lekë të financuara nga të ardhurat dhe nga FZHR, pra nuk janë kryer në kohën e lindjes të detyrimit për t’u paguar nga njësi ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime.</p>	61-62a	I lartë	<p>Drejtoria Ekonomike në Bashkinë SPukë të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin e nënshkrimit të tyre, duke pasqyruar të gjitha detyrimet financiare të lindura nga angazhimi i krijuar nga lidhja e kontratave të lidhura dhe jo thjesht kur ndërhyjnë pagesa, pasi videntimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve është i domosdoshëm për njohjen reale të borxhit të akumuluar dhe marrjen e masave për zvogëlimin gradual të tij.</p>
3.	<p>Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2018, konstatua se:</p> <p>a. Mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas produkteve dhe qendrave të kostos për shpenzimet dhe planifikim jo mbi baza reale të të ardhurave, të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përlllogarisin saktë nevojat për planifikim, por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojnë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj.</p> <p>b. Buxheti për vitin 2018 paraqitet me një performancë jo të kënaqshme në lidhje me</p>	19-21	mesëm	<p>a. Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e buxhetit, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përlllogaritjes së kostos së aktiviteteve në bazë produktesh për çdo program me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve nga këto objektiva. Procesi i planifikimit të buxhetit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim rritjen e transparencës,</p>



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE
USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësi	Rekomandimi
	<p>nivelin mesatar të realizimit të fondeve në masën 84 %, ku ka ndikuar realizimi në nivel të ulët të shpenzimeve operative në masën 59% dhe investimeve në masën 67%, ndërkohë që në datë 31.12.2018 detyrimet e papaguara janë në nivel të lartë në shumën 43,682,262 lekë ose në masën 10% të shpenzimeve totale të planifikuara..</p> <p>c. Kryetari i Bashkisë për vitin 2018 ka përgatitur raporte 4-mujore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe krahasimi i tyre me planifikimin e buxhetit për cdo zë të tij sipa programeve të funksioni të kësaj njësie vendore, duke e paraqitur në Këshillin e Bashkisë. Këto raporte monitorimi janë raportuar vetëm në tregues tregues sasiore pa analizuar dhe shkaqet dhe përcaktuar masat korrigjuese për përmirësimin e situatës.</p>			<p>përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike si dhe përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit të vitit koherent në arritjen e objektivave. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve dhe të sigurojë një përdorim eficient të burimeve financiare, si dhe të ruajë stabilitetin makroekonomik e fiskal.</p> <p>b. Nevojitet të gjurmohet saktë dhe drejtë konsumimi i burimeve të nevojshme, duke synuar shpërndarjen e shpenzimeve (kostove) sipas aktiviteteve që i “shkaktojnë” këto kosto, me qëllim ndjekjen e kujdesshme të kostove për efekte buxhetore duke synuar minimizimin e rishpërndarjeve mes zërave buxhetore brenda vitit ushtrimor. Të rritet performanca e realizimit të buxhetit në nivel të kënaqshëm si për të të ardhurat në bazë reale dhe për shpenzimet në termat e produkteve, si dhe të merren angazhime për të marrë veprimet e duhura korrigjuese për të përmirësuar situatën dhe aty ku është e nevojshme të ndërhyhet.</p>
4.	<p>Nga auditimi i transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se janë kryer pagesa me urdhër-shpenzime në 40 raste në vlerën 23,280,452 lekë mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime dhe investime të mbërritura në institucion, ku një pjesë janë për shkak të kufizimit të limitit të arkës nga MFE për pagesat e vitit 2017 me shkresën nr.15973 datë 09.11.2017 dhe për pagesat e vitit 2018 me shkresën nr.19932 datë 07.11.2018.</p>	22-22	mesën	<p>Bashkia Pukë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos ketë kufizime limiti të arkës për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikujduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 557/1 prot, datë 13.08.2019, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 15.08.2019 deri më datë 06.09.2019, në subjektin Bashkia Pukë u krye auditimi për buxhetin dhe pasqyrat financiare të vitit 2018 me objekt: “Auditimi Financiar)” (Tematik) nga Grupi i Audituesve Shtetërore:

1. I. Sh. *Përgjegjës Grupi*
2. G. Sh.
3. Sh. H.

Titulli: Auditim financiar (Tematik)

Marrësi: Raporti Përfundimtar i Auditimit i drejtohet subjekti të audituar Bashkia Pukë.

Procedura e ndjekur: Projekt Raport auditimi i dërgohet subjektit Bashkia Pukë, pasi nga grupi i auditimit janë dorëzuar në protokoll aktet e mbajtura në lidhje me problematikat e konstatuara dhe nga subjekti.

Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

• **Qëllimi i auditimit:**

Qëllimi i auditimit është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat për pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e Rekomandimeve për përmirësime¹.

• **Objektivat e auditimit synojnë:**

Dhënie e vlerësimeve të pavarura nëpërmjet përcaktimit nga ana e Audituesve:

- nëse pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me rregullave dhe ligjeve të kontabilitetit;
- nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në zbatim të ligjit të Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;

• **Identifikimi i çështjes.**

Projektraport Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmisimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Pukë, si dhe përmisimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaje komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Për këtë janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e organigramës dhe të strukturës organike.

¹-Rregullorja e procedurave të auditimit në KLSH, faqe 28



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

Auditimi ka përfshirë veprimet e kryera hartimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe mbledhja e të ardhurave, hartimi e zbatimi i buxhetit, Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Pukë

• **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim (në vartësi të llojit të auditimit).**

Kryetari i Bashkisë Pukëz. Z. Gj. Gj. (*Nëpunësi autorizues*), dhe Drejtore e Fimamcës dhe Buxhetit dhe e Ndhmës Ekonomike znj. F. P. (*Nëpunësi zbatues*), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi.

Administratori i përgjithshëm dhe Drejtori Ekonomik, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Pukë.

Bazuar në pikën 6 e nenit 34, të ligjit nr. 139/15, dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku thuhet se:

“Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”.

Neni 91. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: pika 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
b) vendosin taksat vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;
ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

Neni 65; “Administrata e njësisë administrative”, pika 1. “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori”.

• **Përgjegjësitë e Audituesve:**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit etj.
- b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- c) Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, etj.)
- e) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320, dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në Bashkinë Pukë, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

• Kriteret e vlerësimit.

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- ✓ Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- ✓ Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- ✓ Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar
- ✓ Ligji nr. 109/2017, datë 18.12.2017 “Për buxhetin e vitit 2018” dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje.
- ✓ Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,
- ✓ Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”
- ✓ UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “ Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin”

• Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË "BASHKINË PUKË"

- ☑ ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik" që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ☑ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- ☑ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.
- ☑ Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

• Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Projektraport Auditimi.

Përgjegjësia është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Pukë dhe përputhshmërinë e aktivitetit në lidhje me zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore për procedurat e prokurimit.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare.

Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në entitetin Bashkia Pukë, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

• Parimet e auditimit financiar:

Në punën tonë Audituesve jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

Ekzistenca: asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

• **Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit.**

Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320** dhe **ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesit konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0.7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për rrjedhojë niveli i precizonit për materialitetin pranohet në vlerën 7,195 mijë lekë për vitin 2018², dhe gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet testeve të kontrolleve.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm u administrua dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar vlerësimin përmes skepticizmit

²Shikoaneksin 1



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analiza të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar si p.sh krahasimet mes buxheteve dhe realizimit faktik; *inspektime* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në letër ose elektronike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe së fundi *kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë.

• **Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:**

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshime.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

³Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm

III- PËRSHKRIMI I AUDITIMIT:

1. Informacioni i përgjithshëm:

Bashkia Pukë është një institucion i rëndësishëm, i cili funksion në bazë të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjes vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

a. Objekti i këtij auditimi, është veprimtaria e operacioneve financiare të kryera nga ana e subjektit Bashkia Pukë përgjatë periudhës 01.01.2018 deri më 31.12.2018.

b. Qëllimi i auditimit, është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e Rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Qëllimi i auditimit është të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuarkështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale **(ISSAI 1315)**⁴.

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të **ISSAI 1700**, ne synojmë të japim një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

c. Fushëveprimi: Auditimi ka përfshirë hartimin e pasqyrave financiare, hartimin dhe e zbatimin e buxhetit dhe planifikimin e mbledhjen e të ardhurave.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, duke vlerësuar evidencat e grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

⁴Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Pukë.

Misioni për njësinë që auditohet është Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (*të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin*).

Objektivat burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

Organi përfaqësues i Bashkisë është Këshilli Bashkiak.

Organi ekzekutiv i Bashkisë është Kryetari i Bashkisë

Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor: krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre, vendos taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkësisë, harton, miraton dhe ndjek zbatimin e buxhetit tyre. Bashkia kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe funksione të deleguara.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit, nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar. Nënpika 1. Programimi i PBA 2017-2019 dhe programimi i buxhetit vjetor 2018. Nënpika 2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bzuar në nivelin e fondeve të çelura; Nënpika 3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimi; Nënpika 4. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi tyre; Nënpika 5. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor. Niveli i arkëtimit të gjobave të vendsoura nga IMTV, apo organe të tjera; Nënpika 6: Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të të ardhurave; Nënpika 7. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre u konsiderua si e nevojshme zhvillimi në ambientet e Aparatit të Bashkisë Pukë i një konstatimi nga audituesit e KLSH-së, znj. I. Sh. (Përgjegjës Grupi), dhe G. Sh. (anëtare) në prezencë të përfaqësuesve të subjektit të auditimit znj. Flora Palushi Drejtoreshë e Financës Buxhetit dhe Ndihmës Ekonomike.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

Në zbatim të germa “B” të Programit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1.Situacioni i shpenzimeve për 2018 i rakorduar me Degën e Thesarit Pukë.
- 2.Urdhri i titullarit për ngritjen e grupit të punës me specialistë të fushës për përgatitjen e projekt buxhetit për vitin 2018.
- 3.Projektbuxheti i paraqitur për vitin 2018 në Këshillin e Bashkisë Pukë.
- 4.Dokumenti i PBA (buxheti afatmesëm 2017-2019) i dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.419/1, datë 01.06.2016.
- 5.Vendimi i Keshillit Bashkiak nr 70 të datës 30.12.2017 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Pukë për vitin 2018”.
- 6.Vendime të tjera të Këshillit për miratimin e ndryshimeve në buxhet.
- 7.Analiza dhe pasqyra financiare të planifikimit të buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet për 2018.
- 8.Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2018 dhe saktësia e pasqyrimit të ndryshimeve në shtesa dhe pakësime me planin përfundimtar.
- 9.Realizimi faktik i buxhetit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet si më poshtë vijon:

Referuar akteve ligjore e nënligjore në vijim:

Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Ligjin nr. 109/2017, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”.

Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

UMF nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

UMF nr. 8, datë 29.03.2012 “ Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

1. Zbatimit të kritereve të hartimit të programeve afatmesme buxhetore u konstatua se:

Bashkia Pukë nisur nga shkresat e Ministria e Financave të dërguara në këtë njësi vendore për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2018-2020 me Urdhrin e titullarit nr.64, datë 08.03.2017.ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) është e miratuar kalendari buxhetor me hapat e procesit, autorët dhe afatet e kryerjes së tyre. Për të realizuar hartimin e programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2018-2020, si dhe projektbuxhetin vjtor 2018 janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje” si dhe janë marrë në konsideratë nevojat brenda mundësive të kërkesave për buxhetim të Sektorëve në varësi të bashkisë.. Në projektbuxhetet afatmesme janë përfshirë plani strategjik i zhvillimit, është përcaktuar misioni, matrica e qëllimeve strategjike, objektivat, fushat prioritare dhe projektet.

Në raportet e projekteve të investimeve janë të plotësuara formulari i propozimit të projektit të investimit si dhe formulari kosto-përfitim. Janë plotësuar vetëm anekset 7.A me tregues vlerorë të pasqyrave nr.1 “Parashikimi i të ardhurave të veta”, pasqyra nr.2 “Përmbledhëse e kërkesave buxhetore sipas burimeve të financimit” të shoqëruara me tregues vlerorë të analizës së tendencave të të ardhurave shpenzimeve me relacionin perkates sipas të Udhëzimeve vjetore të Ministrisë së Financave nr. 7,datë 28.04.2018 “Për përgatitjen e PBA 2018-2020” si dhe Udhëzimit nr.8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”.

Në bazë të dhe Udhëzimeve vjetore të Ministrisë së Financave nr.9/1 datë 25.02.2013 dhe nr.7/1 datë 28.02.2014 “Për përgatitjen e buxhetit vendor” projektbuxhetet vjetore janë hartuar në bazë programi, ku për çdo program janë përcaktuar politika,njësitë shpenzuese objektivat e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE
USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

politikës së programit. Është bërë identifikimi i produkteve përfshirë ato të synuara dhe shpjegimi i kontributit të tyre në objektivat dhe qëllimet e politikës, identifikimi i aktiviteteve të programeve sipas produkteve. Është bërë si dhe përcaktimi i treguesve sasiorë lidhur me të ardhurat shpërndarjen e shpenzimeve. Është bërë dokumentimi i risqeve prioritare të lidhura me objektivat dhe produktet e programit si dhe efektet financiare. Në hartimin e këtyre projekt buxheteve është pasur parasysh realizimi i vitit paraardhës, realizimi i pritshëm për vitin koherent si dhe parashikimi për vitin e ardhshëm.

2. Zbatimi i dispozitave ligjore në hartimin përfundimtar të buxheteve vjetore, akordimin, detajimin, ndryshimet dhe zbatimin e tij u konstatua se:

Programi buxhetor dhe detajimi i tij për vitin 2018 buxheti vjetor është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.70, datë 30.12.2017. VKB për miratimin e Buxhetit vjetor 2018 është konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër, respektivisht për vitin 2018 me shkresën nr.49/1, datë 22.01.2018.

Po kështu me vendimet perkatese te keshillit te Bashkise dhe shkresat e levizje se buxhetit brenda programeve buxhetore jane realizuar levizjet e buxheteve. Në hartimin e këtyre buxheteve është patur parasysh realizimi i viteve të fundit, rritja e të ardhurave nga taksat vendore dhe nevojat për shërbime publike e investime. Në bazë të akt-rakordimeve me Degën e Thesarit Pukë për të ardhurat që trashëgohen burimet e financimit sipas viteve paraqiten:

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2018	
		Ardhurat	Shpenzimet
1	Te ardhura te trashëguara viti 2016	5,060	
2	Transfertë e pakushtëzuar viti 2017/18	107,891	
3	Transfertë e specifike viti 2017,/18	91,801	
4	Plani i të ardhurave viti 2017/18	44,000	
5	Trashëguar nga transfertat viti 2016-2017	61,202	
6	Shtese ne transfertin e vitit 2017		
7	Trashëguar nga FZHR viti 2016		
1	Paga (600)		136,338
2	Sig.shoqërore (601)		22,609
3	Shpenzime operative (602)		53,329
4	Transferta (603+604+605+606+609)		9,003
5	Investime (230 +231) nga buxheti Bashkisë		88,675
	Totali i buxhetit fillestar	309,954	309,954

-Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore sipas manualit të klasifikimit funksional dhe udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave. Gjtë vitit buxhetor 2018 janë bërë këto ndryshime (shtesë nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuar e trashëguar nga viti 2017) miratuar me VKB nr. 10, datë 24.01.2018, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 193/1, datë 14.02.2018, janë bërë dy alokime fondesh të cilat janë miratuar nga këshilli Bashkiak me VKB nr. 34, datë 24.04.2018 dhe NA me Vendimin nr 8 date 13.09.2018. Këto ndryshime pasqyrohen në tabelën e mëposhtme në vlerën totale për secilën llogari dhe të ndarë sipas vitit 2017 dhe 2018.

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Shtesa	Pakësime
1	Paga 600	1,002	800
2	Sigurime shoqërore 601	167	100
3	Shpenz.operative 602		269



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE
USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

4	Shpenzime të tjera (604,609	0	0
5	Investimet (231,230)	2,281	2,281
	Total buxheti me ndryshime	3,450	3,450

3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruar në raportet e monitorimit.

Është rakorduar çdo muaj me degën e thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me degën e thesarit Pukë duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuar nga grantet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore sipas pasqyrës në vijim:

Realizimi i buxhetit për vitin 2018 **Në 000/lekë**

Nr.	Emërtimi	Viti 2018		
		Plan	Fakt	Realiz
1	Paga 600	139,657	130,653	94
2	Sigurime shoqerore 601	23,262	21,681	93
3	Shpenzime operative 602	53,104	31,554	59
4	Transferime 604	5,933	5,583	94
5	Transferime tek individët	108,767	107,956	99
6	Fond Rezerve, kontigjense	3,100	80	3
7	Investime 231	111,315	74,954	67
8	Subvencion Ujesjellesi (603)	2,000	2,000	100
	Total buxheti me	447,138	374,461	84

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se peshën specifike më të madhe në buxhet e kanë shpenzimet për investime të cilat për vitin 2018 zënë 20% të tyre, transfertat tek individët ku bëjnë pjesë ndihmat ekonomike, paaftesia, të cilat për vitin 2018 përbëjnë 29% të tyre. Shpenzimet për pagat dhe sigurimet e punonjësve, për vitin 2018 përbëjnë 35% të tyre. Shpenzimet operative për vitin 2018 zënë 8% të totalit të shpenzimeve. Vlera prej 2,000 mijë lekë e ardhur për vitin 2018 me shkresën e MFE nr. 18125/1 datë 24.10.2018 është përdorur dhe kjo për likuidim Sigurime, TVSH dhe TAP dhe energji elektrike.

Nga realizimi i fondeve buxhetore rezulton se në masën e realizimit prej 84% të fondeve në total kanë ndikuar realizimi në masë të ulët i zërit të buxhetit 602 “Shpenzime operative” në masën 59 % dhe zërit 231 “Investime” në masën 67%.për këto realizime në nivel të ulët nuk ka analizë faktoriale.

4. Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të institucionit dhe të njësive të varësisë, si dhe zbatimi i dispozitave nënligjore në përdorimin e tyre.

Në lidhje me auditimin mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të institucionit dhe të njësive të varësisë, si dhe zbatimi i dispozitave nënligjore në përdorimin e tyre, konstatohet se realizimi i të ardhurave për periudhën 2018 paraqitet në vijim:

Të ardhurat lokale	Viti 2018		
	Plan	Fakt	Real %
TOTALI	44,000	25,510	58

Analizë për investimet

Nga auditimi në lidhje me planifikimin dhe realizimin e investimeve në Bashkinë Pukë u konstatua se për vitin 2018, me financim nga buxheti i Bashkisë, dhe nga FZHR, janë planifikuar



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

investime në vlerën 111,315 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 74,954 mijë lekë sipas sipas Aneksit bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për shpenzimet e reja kapitale janë zbatuar hallkat e miratimit për përfshirjen në buxhet, pasi janë bazuar në prioritetet e caktuara, në kërkesat e paraqitura dhe verifikimit në vend të problemit, duke zhvilluar takime me komunitetin me qëllim nxjerrjen e nevojave reale dhe evidentimin e atyre me imediate. Investimi i cili ka qenë i papërfunduar nga viti parardhës ai është programuar i pari për tu financuar. Bashkia Puke me transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e saj nuk e ka të mundur realizimin e shume investimeve por është përqëndruar tek ato me të domosdoshme për komunitetin. Në vitet 2016-2018 janë realizuar vetëm dy investime të mëdha: a-Rehabilitim i Qendrës Luf dhe b-Reabilitim i qendrës së fshatit Gjegjan”, të tjerat janë punime të vogla fokusuar kryesisht në rrugë rurale, ura këmbësore, tombino, riparime në shkolla etj.

5. Gjendja financiare e Bashkisë, faturat e pa likuiduara, raportimi i tyre për çdo tremujor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe publikimi i tyre në faqen zyrtare elektronike të Bashkisë, krijimi i debitorëve për vendimet gjyqësore të formës prerë, sipas llojeve, regjistrimi i tyre në kontabilitet dhe krijimi sipas viteve, arsyet (Kjo edhe në formë tabelore).

- Në total treguesit e buxhetit për vitin 2018 janë realizuar në masën 84%. Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të të ardhurave dhe mosrealizimi për efekt të vendosjes së limitit të likuidimeve nga Ministria e Financave, sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve. Planifikimi i zërit të shpenzimeve është bërë pa llogaritur detyrimet kreditore, të cilat bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare, në datën 31.12.2018 Bashkia Pukë ka një detyrim ndaj të tretëve prej 43,682,262 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e metodologjisë së planifikimit të buxhetit dhe nenin 52, -Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapa mbetura”, Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018, “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 – Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Faturat e palikuiduara janë raportuar çdo tre-mujor në Ministrinë e Financave.

Në total sipas zërave faturat e pa likuiduara paraqiten në fund të vitit 2018 në vlerën 43,682,262 lekë dhe në fund të 8-mujorit të vitit 2019 në vlerën 35,191,905 lekë. Në mënyrë të përmbledhur këto detyrime paraqiten në tabelën e mëposhtme e konkretisht për faturat e pa likuiduara për Investimet e kryera, për faturat e pa likuiduara për vendimet e gjykatave dhe për faturat e palikuiduara për blerje mallra e shërbime të klasifikuara në llogarinë buxhetore 602 “Shpenzime operative” dhe gjendja e detyrimeve për Vendime të Gjykatës të formës së prerë.

Pasqyra e faturave të pa likuiduara në mbyllje të vitit ushtrimor 2018 dhe deri me date 30.08.2019 në tabelën në vijim:

Në lekë

Nr	Emërtimi i llojit të Detyrimeve	Fatura te pa likuiduar deri në 31.12.2018	Fatura te pa likuiduar deri në 30.08.2019
1	Investime	24 253 399	20,470,874
2	Vendime Gjykate	11 532 789	8,886,856
3	Fatura te palikuiduara (mallra e shërbime)	7,896,074	5,834,175
	Totali	43,682,262	35,191,905

Ndikimi në shkurtime të buxhetit apo bllokimi nga MFE në fund të vitit në krijimin e detyrimeve të prapambetur.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

Limiti i vendosur nga MFE, ka ndikuar në krijimin e faturave të praâmbetura pasi ka pasur fonde për likuidim dhe faturat kanë mbetur të palikuiduara duke shtuar vlerën e detyrimeve të paraqitura në bilanc ku për vitin 2017 vlera totale e detyrimeve ka qenë 75,865,234 lekë (përfshirë dhe faturat e muajit dhjetor 2017) nga te cilat për arsye limiti vlera ka qenë 40, 637, 028 lekë.

Janë likuiduar totalisht ato të lindura për arsye limit me vlerë totale 40,637,028 lekë ndërsa nga detyrimet e trashëguara nga vitet e mëparshme në vitin 2017 janë likuiduar 13,273,924 lekë dhe në vitin 2018 shuma 1,888,118 lekë, pra nga Bashkia është bërë përpjekje për shlyerjen e detyrimeve por në total është e pamundur me buxhetin aktual.

6. Paraqitja në këshillin e njësive të vetëqeverisjes vendore (këshillin bashkiak) nga ana e Bashkisë, të raporteve 4 mujore të monitorimit të buxhetit për performancën financiare dhe objektivat e realizuara për çdo program buxhetor, etj.

Kryetari i Bashkisë për vitin 2018 janë përgatitur raporte 4-mujore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe krahasimi i tyre me planifikimin e buxhetit për cdo zë të tij sipa programeve të funksioni të kësaj njësie vendore, duke e paraqitur në Këshillin e Bashkisë. Këto raporte monitorimi janë raportuar vetëm në tregues tregues sasiore pa analizuar dhe shkaqet dhe përcaktuar masat korrigjuese për përmirësimin e situatës.

Konkluzion: Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2018, u konstatua se:

a. Mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas produkteve dhe qendrave të kostos për shpenzimet dhe planifikim jo mbi baza reale të të ardhurave, të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përlllogarisin saktë nevojat për planifikim, por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojnë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj.

b Buxheti për vitin 2018 paraqitet me një performancë jo të kënaqshme në lidhje me nivelin mesatar të realizimit të fondeve në masën 84 %, ku ka ndikuar realizimi në nivel të ulët të shpenzimeve operative në masën 59% dhe investimeve në masën 67%, ndërkohë që në datë 31.12.2018 detyrimet e papaguara janë në nivel të lartë në shumën 43,682,262 lekë ose në masën 10% të shpenzimeve totale të planifikuara.

c. Kryetari i Bashkisë për vitin 2018 janë përgatitur raporte 4-mujore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe krahasimi i tyre me planifikimin e buxhetit për cdo zë të tij sipa programeve të funksioni të kësaj njësie vendore, duke e paraqitur në Këshillin e Bashkisë. Këto raporte monitorimi janë raportuar vetëm në tregues tregues sasiore pa analizuar dhe shkaqet dhe përcaktuar masat korrigjuese për përmirësimin e situatës.

Këto veprime janë në kundërshtim me nr.UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354.

1. Titulli i Gjetjes: KLSH nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2018, konstaton performance jo e kënaqshme e programimit dhe realizimit të buxhetit, mungesa e analizave faktoriale të tij si dhe mangësi në monitorimin e buxhetit.

Situata: Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2018, u konstatua se:

a. Mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas produkteve dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

qendrave të kostos për shpenzimet dhe planifikim jo mbi baza reale të të ardhurave, të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përlogarisin saktë nevojat për planifikim, por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojnë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj.

b. Buxheti për vitin 2018 paraqitet me një performancë jo të kënaqshme në lidhje me nivelin mesatar të realizimit të fondeve në masën 84 %, ku ka ndikuar realizimi në nivel të ulët të shpenzimeve operative në masën 59% dhe investimeve në masën 67%, ndërkohë që në datë 31.12.2018 detyrimet e papaguara janë në nivel të lartë në shumën 43,682,262 lekë ose në masën 10% të shpenzimeve totale të planifikuara..

c. Kryetari i Bashkisë për vitin 2018 janë përgatitur raporte 4-mujore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe krahasimi i tyre me planifikimin e buxhetit për cdo zë të tij sipa programeve të funksioni të kësaj njësie vendore, duke e paraqitur në Këshillin e Bashkisë. Këto raporte monitorimi janë raportuar vetëm në tregues tregues sasiorë pa analizuar dhe shkaqet dhe përcaktuar masat korrigjuese për përmirësimin e situatës.

Kriteri Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nënart 42,43,47,50,52 dhe 65, me UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354.

Ndikimi/Efekti - Performancë e jo kënaqshme në lidhje me nivelin e ulët të realizimit të fondeve në shpenzime operative në masën 59% dhe investime në masën 67%, ndërkohë që në datë 31.12.2018 detyrimet e papaguara janë në nivel të lartë në shumën 43,682,262 lekë ose në masën 10% të shpenzimeve totale të planifikuara, duke sjellë mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të realizimit të funksioneve të saj dhe shërbimeve.

Shkaku - Akumulimi i një borxhi të konsiderueshëm në fund të vitit 2017 në vlerën 75,865,234 lekë për arsye limiti të vendosur nga MFE, ka ndikuar në krijimin e faturave të praambetura pasi ka patur fonde për likuidim si dhe realizimi i të ardhurave në masë të ulët prej 58%, pavarësisht shlyerjes në masën 43% të detyrimeve të trashëguara nga viti 2017, duke ulur detyrimin në fund të vitit 2018 në shumën 43,682,262 lekë dhe në 30.08.2019 në shumën **35,191,905 lekë** .

Rëndësia: -I mesëm.

Rekomandimi **a.** Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e buxhetit, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përlogaritjes së kostos së aktiviteteve në bazë produktesh për cdo program me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve nga këto objektiva. Procesi i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

planifikimit të buxhetit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike si dhe përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit të vitit koherent në arritjen e objektivave. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve dhe të sigurojë një përdorim eficient të burimeve financiare, si dhe të ruajë stabilitetin makroekonomik e fiskal.

b. Nevojitet të gjurmohet saktë dhe drejtë konsumimi i burimeve të nevojshme, duke synuar shpërndarjen e shpenzimeve (kostove) sipas aktiviteteve që i “shkaktojnë” këto kosto, me qëllim ndjekjen e kujdesshme të kostove për efekte buxhetore duke synuar minimizimin e rishpërndarjeve mes zërave buxhetore brenda vitit ushtrimor. Të rritet performanca e realizimit të buxhetit në nivel të kënaqshëm si për të të ardhurat në bazë reale dhe për shpenzimet në termat e produkteve, si dhe të merren angazhime për të marrë veprimet e duhura korrigjuese për të përmirësuar situatën dhe aty ku është e nevojshme të ndërhyhet.

Konkluzion: Nga auditimi i transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se janë kryer pagesa me urdhër-shpenzime në 40 raste në vlerën 23,280,452 lekë mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime dhe investime të mbërritura në institucion për shkak të kufizimit të limitit të arkës nga MFE për pagesat e vitit 2017 me shkresën nr.15973 datë 09.11.2017 dhe për pagesat e vitit 2018 me shkresën nr.19932 datë 07.11.2018, në mosrespektim të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52 në të cilën përcaktohet se: *“Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.”*Në mënyrë të detajuar paraqesim rastet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Urdhër shpenzim		Vllera	Fatura tatimore		Nr	datë	Arsyeja e vonesës
	nr	datë		Lloji mallit dhe shërbimit				
1	45	08.02.2018	440640	Sherbim		385	17.11.2017	
2	47	08.02.2018	117000	Sherbime		223	14.12.2017	
3	48	08.02.2018	21000	Sherbime		228	18.12.2017	
4	49	08.02.2018	9360	Sherbime		229	20.12.2017	
5	50	08.02.2018	63600	Paisje, materiale		31	22.12.2017	
6	52/1	08.02.2018	4353603	Rehabilitimi Qend. Fshati Gjegjan		52/1	01.12.2017	MF
7	54	09.02.2018	453600	Hapje rrug. NJA Qelëz		14	1.12.2017	
8	55	09.02.2018	8400	kolaudim objekti		30	30.12.2017	
9	133	19.03.2018	14830	BI paisje kompjutera		17	27.12.2017	MF
10	134	19.03.2018	407976	BI paisje Pll kult		263	15.12.2017	MF
11	137	21.03.2018	10738344	Rik Rr. Lumzi, B.puk		33	30.11.2017	
12	429	28.08.2018	4762204	Rikonstruksioni Rr. Lumzi, B.puk		41	04.12.2017	
13	146	06.04.2018	27600	Mbikq punime vend depozitimi mbetjeve		112	26.12.2017	
14	151	06.04.2018	63360	Mbikq punime rReab qendra fshati gjegjan		82	07.2012	
15	171	11.04.2018	142 700.00	Material sherb special ushqimor		123, 131,148	03.11.2017	
16	689	20.12.2018	23976			218	31.10.2018	
17	690	20.12.2018	3300	Blerje materiali		21	07.11.2018	
18	691	21.12.2018	11748	Blerje buke		82	31.10.2018	
19	695	21.12.2018	7664	Blerje buke		83	30.10.2018	
20	696	21.12.2018	102600	Situacion pjesor Rikons konvikti “ Ali		44	22.10.2018	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

				Bytyçi			
21	714	27.12.2018	66,736	Bileta udhëtimi	287	16.11.2018	MF
22	715	27.12.2018	86160	Trajtim per sportist	357	12.11.2018	MF
23	719	27.12.2018	25992	Likuj fatura ushqimore	197	16.10.2018	MF
24	720	27.12.2018	104676	Likujdim fatura ushqimore	208,209	24.10.2018	MF
25	721	27.12.2018	26892	Likujdim fatura ushqimore	211,212	31.10.2018	MF
26	722	27.12.2018	15055	Likujdim fatura ushqimore	251,252	31.10.2018 01.11.2018	MF
27	723	27.12.2018	146706	Likujdim fatura ushqimore	228,230231,232	09.11.2018	MF
28	725	27.12.2018	13914	Likujdim fatura ushqimore	243,246	19.11.2018	MF
29	730	27.12.2018	98554	Uj i pijshem	394,396,409,404, 435,434,	28.10.2018	MF
30	732	27.12.2018	298800	Shpenzim transporti	254	16.11.2018	MF
31	734	27.12.2018	51240	Blerje paisje guzhine	24	07.11.2018	
32	735	27.12.2018	238680	Likujdim fatura ushqimore	26	30.10.2018	MF
33	736	27.12.2018	90000	Pjesë këmbimi	14	08.11.2018	MF
34	737	27.12.2018	79200	Sherb.ngrohje	22,23	07.11.2018	MF
35	738	27.12.2018	20683	Blerje materiale dru	19	05.11.2018	
36	739	27.12.2018	22683	Prerje transport	19	14.11.2018	
37	740	27.12.2018	52927	Prerje transport	18	13.11.2018	
38	741	27.12.2018	22683	Prerje transport	5	01.10.2018	
39	743	27.12.2018	22683	Prerje transport	6	02.10.2018	
40	744	27.12.2018	22683	Prerje transport	67	09.10.2018	
		Totali	23,280,452				

2. Titulli i Gjetjes: KLSH nga auditimi i transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se janë kryer pagesa me urdhër-shpenzime në 40 raste në vlerën 23,280,452 lekë mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime dhe investime të mbërritura në institucion për shkak të kufizimit të limitit të arkës nga MFE për pagesat e vitit 2017 me shkresën nr.15973 datë 09.11.2017 dhe për pagesat e vitit 2018 me shkresën nr.19932 datë 07.11.2018, në mosrespektim të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52

Situata:

Nga auditimi i transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se janë kryer pagesa me urdhër-shpenzime në 40 raste në vlerën 23,280,452 lekë mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime dhe investime të mbërritura në institucion për shkak të kufizimit të limitit të arkës nga MFE për pagesat e vitit 2017 me shkresën nr.15973 datë 09.11.2017 dhe për pagesat e vitit 2018 me shkresën nr.19932 datë 07.11.2018,

Kriteri

Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në mosrespektim të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52

Ndikimi/Efekti

Moslikujdimi i në kohë i shpenzimeve sjell akumulim i borxhit të institucionit për fatura të palikujduara

Shkaku

Në pjesën më të madhe të rasteve të vonesave në likujdim me tejkalim afati ligjor prej 30 ditësh, ka ardhur si rezultat i vendosjes së limit të kufizuar të arkës për likujdim nga MFE në fund të viteve ushtrimore 2017-2018, për mungesë likujditetesh.

Rëndësia:

-I mesëm.

Rekomandimi

Bashkia Pukë të marrë masa për sigurimin e likujditeteve, në mënyrë që të mosketë kufizime limiti të arkës për likujdimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

palikujduar dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” kapitulli III, pika 30., me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32., me UMF nr. nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 28, me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi znj.F. P. me detyrë Drejtore Ekonomike e Buxhetit dhe Ndhmës Ekonomike, në cilësinë e nëpunësit zbatues (NZ), dhe hartueses së pasqyrave financiare.

➤ Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave dhe tarifave vendore.

1. Krijimi i strukturave për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore;

Në Bashkinë Pukë për periudhën objekt auditimi ka funksionuar Zyra Tatim Taksave me strukturë të rregullt,

Për vitin 2018 me VKB Nr. 68, date 30.12.2017 Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2018 të Bashkisë Pukë”, protokolluar me nr.12/1, datë 05.01.2018, ndryshuar me VKB nr.21, datë 23.03.2018, protokolluar me nr.561, datë 27.03.2018. Të gjitha këto vendime sipas viteve respektive janë miratuar nga ana e Prefektit të Qarkut Shkodër.

2. Parashikimi, realizimi dhe përdorimi i taksave vendore sipas llojeve, rezervat në planifikim;

Në lidhje me auditimin e kryer mbi parashikimin, realizimin dhe përdorimin e taksave vendore sipas llojeve, rezervat në planifikim, rezulton se:

Për vitin 2018, programimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, është miratuar në vlerën 44,000 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 25,510 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 18,490 mijë lekë, ose 58%. Realizimi i të ardhurave është në nivele shumë të ulët për vitin 2018.
Në 000/lekë

Nr	EMERTIMI	Viti 2018			NR	EMERTIMI	Viti 2018		
		Plani	Fakt	%			Plani	Fakt	%
I	Te ardhura nga taksat vendore	11,264	8,398	75	III	Te ardhura te tjera	23,353	9,189	39
1	Takse për kalimin e se drejtës se pronësisë	0	0	0	1	Te ardhura qiratë (mjete+godine+toke)	11,410	6,373	56
2	Takse e automjeteve te përdorura	2,800	3,104	111	2	Te ardhura aplikimi i gjobave e debitorë	8,198	314	4
3	Taksa e biznesit te vogël (T Thjeshtuar)	1,290	97	8		Renta Minerare	2,500	42	2
4	T pasurisë paluajtshme (ndërt+tok bujq.)				3	Te ardhura kopshtet, çerdhet dhe shkollat	864	1,008	117
4.1	Takse pasurie e paluajtshme ndërtesa	4,467	3,067	69	4	Te ardhura nga institucionet vartëse			
4.2	Taks pas paluajtshme toke bujqësore	124	40	32	4.3	Te ardhura nga Shumesportet	0	0	0
5	Takse trualli	438	165	38	4.4	Nga buxheti i pushtetit vendor	1,360	1,360	100
6	Takse e fjetjes ne hotel	230	171	74	4.5	Sponcorizime nga fondacionet	0	20	
7	Taksa e ndik infrastruk ndërtime e reja	1,156	1,088	95	4.6	Te ardhura nga pullat	50	42	84
8	Takse table + reklame	529	525	99	5	2% tatim mbi te ardhurat	331	0	0
9	Takse parkimi	230	141	61	6	Te ardhura nga pagesa sherbimesh	0	30	300
II	Te ardhurat nga tarifat vendore	9,383	7,923	84					



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

1	Tarife për zënien e hapësirave publike								
1.1	Tarife tregu	600	754	126					
1.2	Tarife e zënies se hapësirave publike	311	273	88					
2	Tarife vjetore pastrim ,ndriçim, gjelbërim	6,482	5,112	79					
3	Tarife 0.5% legalizimet	150	0	0					
4	Tarife për leje dhe shërbim veterinar	30	5	17					
5	Tarife shërbime tjera nga pushteti vendor	0	0	0					
6	Tarife MNZZH	20	402	201					
				0					
7	Tarife ujitjes tokave bujqesore	50	27	54					
8	Tarife shitje dru zjarri	1,450	1,262	87					
9	Tarife për leje dhe certifikata transporti	290	88	33	IV	TOTALI I TE ARDHURAVE (Taks Tarif	44,000	25,510	58

Për vitin 2018, ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat lokale, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksat vendore, e cila është programuar në masën 11,264 mijë lekë, realizuar në masën 8,398 mijë lekë ose 75%. Mosrealizimi ndaj totalit është në masën 2,866 mijë lekë, me ndikim në mosrealizim në masën 11,2%.

-Ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga tarifet lokale, ka mos realizimi i të ardhurave nga të ardhurat nga Renta Minerare, e cila është programuar në masën 25,000 mijë lekë, realizuar në masën 42 mijë lekë ose 2%. Mosrealizimi ndaj totalit është në masën 2,458 mijë lekë, me ndikim në mosrealizim 9,6%.

-Ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga tarifet lokale, ka mos realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit, ndricimi, gjelbërimit e cila është programuar në masën 6,482 mijë lekë, realizuar në masën 5,112 mijë lekë ose 79%. Mosrealizimi ndaj totalit është në masën 1,370 mijë lekë, me ndikim në mosrealizim në masën 5,3%.

Konstatohet se shpenzimet faktike të vitit 2018 rezultojnë në vlerën 374,461 mijë lekë kurse të ardhurat faktike rezultojnë 25,510 mijë lekë ose 7% e tyre mbulohen nga të ardhurat e veta.

Të ardhurat janë rakorduar me Degën e Thesarit çdo muaj dhe në mënyrë progresive për çdo vit. Programimi dhe realizimi i të ardhurave sipas NjA periudha viti 2018 paraqitet në tabelë:

Nr	Njësia Administrative	Viti 2018			
		Plan	Plan	Fakt	%
1	Bashkia Pukë	24,668	26,820	19,820	74
2	Nj A Gjegjan	6,221	7,654	810	11
3	Nj A Qerret	3,888	6,314	2,594	41
4	Nj A Qelëz	694	452	80	18
5	Nj A Rrape	2,010	2,424	2,205	91
	TOTALI	37,500	44,000	25,510	58

3. Krijimi i regjistrit të tatim paguesve në mënyrë manuale dhe elektronike. Kontrollat e bëra për grumbullimin e taksave, rakordimi me agjentët tatimorë, problemet e dala dhe masat e marra;

Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore janë hapur regjistrat në mënyrë manuale dhe elektronike ku janë regjistruar të gjithë tatim paguesit që kanë detyrimin për pagimin e taksave dhe tarifave vendore.

Sipas dokumentacionit të paraqitur nga personeli i Zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë, u përzgjedhën për auditim 15 subjekte me aktivitet të ndryshme, të biznesit të vogël dhe biznesit të madh, për përcaktimin dhe llogaritjen detyrimeve për taksat dhe tarifet vendore si për tarifën e pastrimit urban, për tarifën e ndriçimit, për tarifën e gjelbërimit, për taksën e tabelës për qëllime identifikimi dhe reklamimi, për taksën mbi ndërtesën dhe nuk u konstatuan probleme. Më hollësisht janë trajtuar në Raportin Përfundimtar të auditimit të dërguar nga KLSH me shkresën nr.1432/8.datë 19.08.2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

4. Gjendja e debitorëve për taksat vendore, në numër dhe vlerës, sipas bizneseve, taksës tokës, taksat e popullatës, etj, kontratat për shfrytëzimin e sipërfaqes dhënë sipas Lejeve Minerare, apo Lejeve Koncesionare për pasurinë në administrim të tyre;

Nga auditimi i të dhënave të Zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore, rezulton se gjendja e debitorëve për periudhën viti 2018, paraqitet sipas pasqyrës si vijon:

Pasqyra e gjendjes së debitorëve në fund të vitit 2018. Në / lekë.

EMËRTIMI	31.12.2018	
	Nr.	Vlerë
Biznesi Vogël	73	4,509,165
Biznes i Madh	16	5,505,078
TOTALI	89	10,014,243

Për detyrimet debitore për kontratat për shfrytëzimin e sipërfaqes dhënë sipas Lejeve Minerare, apo Lejeve Koncesionare për pasurinë në administrim të tyre, gjendje më 31.12.2017 dhe më 31.12.2018 sipas dokumenteve të paraqitura nga specialistët e zyrës së taksave dhe tarifave vendore u konstatua se janë evidentuar dhe konkretisht:

Për vitin 2018, debitor nga KLSH janë në vlerën 1,163,246 lekë, debitor për kontratat e qirave janë në vlerën 5,692,399 lekë dhe debitor për taksat e tarifa vendore për institucionet shtetërore janë në vlerën 79,000 lekë.

Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore Bashkia Pukë, janë evidentuar detyrimet debitore, për cdo subjekt të biznesit të madh e të biznesit të vogël, janë përlogaritur edhe kamat vonesat rregullisht për çdo vit për personat që nuk kanë paguar në afat detyrimet e ngarkuara sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli i Bashkisë.

Më hollësisht janë trajtuar në Raportin Përfundimtar të auditimit të dërguar nga KLSH me shkresën nr.1432/8.datë 19.08.2019

5. Administrimi i kontratave të lidhura për dhënien me qira të pasurisë së Bashkisë apo Njesisë Administrative (Ambiente, Toka, Pyje, Kullota, etj.);

Në auditimin e kryer për administrimin e kontratave të lidhura për dhënien me qira të pasurisë së Bashkisë apo Njesisë Administrative, Ambiente, Toka, Pyje, Kullota, etj, në zbatim të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, deri 31.12.2018, objekt auditimi.

Gjatë auditimit të dokumentacionit të paraqitur nga punonjësit e bashkisë për dhënien me qira të pasurive të institucionit të qeverisjes vendore dhe konkretisht kontratat e trashëguara dhe të përthithura nga ish Komunitat aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë. Nga auditimi i kryer për monitorimin e arkëtimit të detyrimeve nga dhënia e objekteve të ndryshme me qira, në vijim po paraqesim kontratat e qiradhënies të cilat nuk janë kryer arkëtimet sipas përcaktimeve dhe detyrimeve midis palëve.

Më hollësisht janë trajtuar në Raportin Përfundimtar të auditimit të dërguar nga KLSH me shkresën nr.1432/8.datë 19.08.2019

6. Zbatimin e procedurave ligjore në arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për taksave e tarifave vendore dhe llogaritja e kamat vonesave, në zbatim të neneve 90 dhe 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Sipas dokumenteve të paraqitura nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohet se detyrimet progresive për tatim taksat lokale, deri më datën 31.12.2018, sipas të dhënave që na u paraqitën, është në shumën totale për 10,014 mijë lekë, nga 89 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël, e detajuar jepet sipas të dhënave të pasqyrës që vijon në 000/lekë:



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

Pasqyra e gjendjes së debitorëve në fund të çdo viti 2018. Në / lekë.

EMËRTIMI	31.12.2018	
	Nr.	Vlerë
BiznesiVogël	73	4,509,165
Biznes i Madh	16	5,505,078
TOTALI	89	10,014,243

Më hollësisht janë trajtuar në Raportin Përfundimtar të auditimit të dërguar nga KLSH me shkresën nr.1432/8.datë 19.08.2019

7. Në se Zyra e taksave, Zyra e administrimit Aseteve dhe Drejtoria e Planifikimit Territorit kanë rakorduar me Drejtorinë Rajonale të ALUZNIT, për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e legalizuara, në përputhje me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë. (Gjatë periudhë së auditimit në bashkëpunim me ALUIZNIN të nxirren listat e personave që duhet të paguanin sa, kanë paguar dhe sa nuk kanë paguar deri në periudhën e auditimit)*

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga zyra e ALUIZNI-Drejtoria Shkodër, nga dokumentacioni i servitur për 31.12.2018, konstatohet se nga 28 persona të pajisur me leje legalizimi për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi, vlera e detyrimit në total për taksën e ndikimit në infrastrukturë është 405,336 lekë nga të cilat kanë shlyer detyrimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë 23 persona në vlerën 252,065 lekë, ngelet diferenca prej 153,271 lekë e pa likuiduar për pesë objekte në zbatim të ligjit nr. 9482 datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, ku cilësohet: “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë llogaritet dhe arkëtohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me pikën 2/1, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”.

Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Pukë, konstatohet se deri më 31.12.2018, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 5 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 932,6 m².

Më hollësisht janë trajtuar në Raportin Përfundimtar të auditimit të dërguar nga KLSH me shkresën nr.1432/8.datë 19.08.2019

8.Mbi organizimin dhe funksionimi i Policisë Bashkiake.

-Nga policia bashkiake sipas dokumentacionit rezulton se është dokumentuar puna për bashkëpunimin me zyrën e tatim taksave për vjeljen e detyrimeve tatimore, në se janë ushtruar kontrole mbi territorin nën administrim të saj, në se janë dokumentuar me procesverbale të përbashkëta pune ushtrimi i kësaj detyre, në zbatim me nenin 8, pika 3, të ligjit nr.8224 datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë”.

Në lidhje me administrimin e blloqeve të gjobave si letra me vlerë dhe për rastet e largimit të punonjësve nga puna në se kanë dorëzuar detyrën dhe blloqet e gjobave me proces verbal, për periudhën objekt auditimi rezultoi se nuk ka ndryshim dhe lëvizje të kryeinspektorit të policisë së Bashkisë. Gjatë kësaj periudhe nuk ka raste të largimit nga puna të punonjësve të Policisë Bashkiake. Struktura e policisë bashkiake përbëhet nga 1 kryeinspektor dhe 2 policë.

- U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Regjistri i gjobave i Policisë Bashkiake.

Evidenca të tjera si dhe mandat arkëtimet e gjobave, periudha për vitet 2017 dhe 2018.

Në lidhje me realizimin e të ardhurat nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake, pasqyrimi i tyre në Regjistrin e gjobave, dërgimi i listës gjobave në fund të secilit vit në Zyrën e financës, masat e mara për arkëtimin e tyre dhe llogaritja e kamat vonesave për mos pagimin e tyre në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

afat, konstatohet se nga punonjësit e policisë, për shkeljet e vërejtura, janë mbajtur procesverbale dhe janë aplikuar gjoba, ndaj subjekteve për shkeljet e konstatuara ndaj personave të ndryshëm, për zënie të hapësirave publike si dhe janë orientuar subjektet shkelëse në mos përsëritjen e veprimeve si dhe ndjekjen dhe zbatimin e procedurave dhe detyrimeve ligjore, në të ardhmen.

Për periudhën objekt auditimi janë vendosur gjoba nga Policia Bashkiakepër 74 raste, për shkelje të ndryshme në vlerë të përgjithshme prej 103,000 lekë. Janë arkëtuar gjobat e vendosura në 39 raste dhe nuk janë arkëtuar gjobat për 35 rastet e tjera,

Më hollësisht janë trajtuar në Raportin Përfundimtar të auditimit të dërguar nga KLSH me shkresën nr.1432/8.datë 19.08.2019

C. Vlerësimi i Raportimit Financiar, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”; udhëzimin e MF nr. 26, datë 27.12.2007, për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, date 28.12.2006, dhe udhëzimi i MFE nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme“, etj, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për 2018, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë.

Nënpika 1.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

Nënpika 1.2. Vlerësimi i arsyeshem e i bazuar (në rastet, kur vlerësimet janë të domosdoshme). Nënpika 1.3 Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancën financiare dhe fluksit të parasë të nënjësisë. Nënpika 1.4. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

Për auditimin e pikës 3.2 **u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:**

1. Pasqyrat financiare të viteve 2018 të shoqëruar me formatet 1-9.
2. Dokumenta kontabël si: ditaret e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2018, libri i aktiveve.
4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2018
6. Akordimet me Degën e Thesarit Pukë në mbyllje të vitit buxhetor 2018.
8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet, per ditaret, shpenzimet te ardhurat etj.).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2018 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Pukë” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, VKM



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

nr.248, datë 10.04.1998 pika 3, ndryshuar me VKM nr.25, datë 20.01.2001, UMF nr.26, datë 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qëndrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj”, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Pukë si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

• **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara për të gjitha njësitë shpenzuese të varësisë është kryer.**

Për vitin 2018 janë hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara në nivel Bashkie, duke përfshirë PF e Aparatit të Bashkisë Pukë dhe SHA Ujesjelles Kanalizime Bashkia Puke. Nga verifikimi i këtyre pasqyrave rezulton se është bërë mbledhja aritmetike e gjendjeve të llogarive respektive të Bilanceve të këtyre nënvarësive. Shuma e Aktivit rakordon me shumën e Pasivit të bilancit të konsoliduar si dhe Aktivet Neto janë të barabarta me Fondin e Konsoliduar. Po ashtu nga verifikimi i shifrave të pasqyrës së performancës financiare për të ardhurat dhe shpenzimet sipas natyrës ekonomike Formati 1, rezultoi se të ardhurat minus shpenzimet është e barabartë me rezultatin e vitit ushtrimor, përfshirë ndryshimin e gjendjes së inventarit qarkullues pra gjendja e llogarisë 85 “Teprica ose deficit i periudhës” në formatin 2 është e barabartë me gjendjen e llogarisë 85 të formatit “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”, ku për vitin 2018 është në shumën 52,435,532 lekë dhe për vitin 2017 është në shumën 64,053,816 lekë. Pasqyrat formateve 1 dhe 2 të konsoliduara të Bashkisë Puke paraqiten në tabelën e mëposhtme: Formati nr. 1 “Përmbledhëse Bashkia Pukë (Pasqyra e Pozicionit Financiar) Aktiv+Pasiv

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	EMERTIMI	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	AKTIVET	1,974,254,237	2,123,696,497
2		I.Aktivët Afat shkurtër	204,121,143	245,992,326
3		1.Mjete monetare dhe ekujivalent të tyre	75,924,966	85,796,404
4	531	Mjete monetare ne Arke	0	0
5	512,56	Mjete monetare ne Banke	825,459	524,317
6	520	Disponibilitete ne Thesar	74,020,027	84,229,867
7	50	Letra me vlere	0	0
8	532	Vlera te tjera	1,079,480	1,042,220
9	54	Akreditiva dhe paradhenie	0	0
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)	0	0
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	19,389,797	16,251,688
12	31	Materiale	4,987,089	3,991,670
13	32	Inventar I imet	14,321,569	12,165,571
14	33	Prodhim nre proces	0	0
15	34	Produkte	0	0
16	35	Mallra	81,139	94,447
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri	0	0
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve	0	0
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit	0	0
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)	0	0
21		3.Llogari te Arketushme	66,354,145	69,813,061
22	411	Kliente e llogari te ngjashme	0	0
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	0	0
24	431	Tatim e Taksa	0	0
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal	0	0
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti	0	0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

27	435	Sigurime Shoqerore	0	0
28	436	Sigurime Shendetstore	0	0
29	437,438,	Organizma te tjere shtetore	0	0
30	44	Institucione te tjera publike	0	0
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere	0	0
32	468	Debitore te ndryshem	51,775,967	55,073,920
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	14,578,178	14,739,141
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike	0	0
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)	0	0
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	42,452,235	74,131,173
37	409	Parapagime	0	0
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin	0	0
39	477	Diferenca konvertimi aktive	0	0
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime	0	0
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	42,452,235	74,131,173
42		II.Aktivitet Afat gjata	1,770,133,094	1,877,704,171
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	966,960	10,015,337
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave	0	0
45	202	Studime dhe kerkime	966,960	10,015,337
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme	0	0
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	1,265,942,013	1,434,509,334
48	210	Toka, T,roje, Terene	4,434,645	4,434,645
49	211	Pyje, Plantacione	12,560,284	15,700,355
50	212	Ndertesa e Konstruksione	450,264,456	469,385,274
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	689,362,581	827,875,141
52	214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	15,313,822	14,308,638
53	215	Mjete Transporti	5,513,665	2,232,466
54	216	Rezerva Shtetore	0	0
55	217	Kafshe pune e prodhimi	0	0
56	218	Inventar ekonomik	32,886,189	42,039,793
57	24	Aktive afatgjata te demtuara	0	0
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	55,606,371	58,533,022
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	147,151,000	143,651,000
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie	0	0
61	26	Pjesmarrije ne kapitalin e vet	147,151,000	143,651,000
62		4.Investime	356,073,121	289,528,500
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale	0	0
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	356,073,121	289,528,500
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	126,069,882	156,734,707
66		I.Pasivet Afat shkurtra	126,069,882	156,734,707
67		1. Llogari te Pagushme	124,792,202	155,500,987
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	1,348,087	2,288,501
69	42	Detyrime ndaj personelit	13,918,585	12,683,921
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra	0	0
71	460	Huadhenes	0	0
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	4,209,627	3,457,711
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal	0	0
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore	0	0
75	435	Sigurime Shoqerore	2,827,831	2,637,256
76	436	Sigurime Shendetstore	384,302	414,564
77	437,438,	Organizma te tjere shtetore	0	0
78	44	Institucione te tjera publike	0	0
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike	0	0
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere	0	0
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	20,936,100	19,154,365
82	467	Kreditore te ndryshem	46,082,279	79,511,180
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	35,085,391	35,353,489
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)	0	0
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	1,277,680	1,233,720
86	419	Kreditore, Parapagime	198,200	191,500
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese	1,079,480	1,042,220
88	478	Diferenca konvertimi pasive	0	0
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar	0	0
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se ttitullit	0	0
91		II.Pasivet Afat Gjata	0	0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

92	Klase 4	Llogari te pagushme	0	0
93	16.17,18	Huate Afat gjata	0	0
94		Provigjonet afatgjata	0	0
95	Klasa 4	Te tjera	0	0
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,848,184,355	1,966,961,790
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,848,184,355	1,966,961,790
42	7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve		633,000
44	7114	Te ardhura nga biletat		5,300
45	7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestri e zhdemtime	344,302	18,678,591
46	7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
47	719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore		
48	76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE	0	0
49	760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
50	761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
51	765	Nga interesat e depozitave		
52	766	Nga kembimet valutore		
53	72	V.GRANTE KORENTE	328,235,424	402,153,387
54	720	1.Grant korent I Brendshem	328,235,424	402,153,387
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)		
56	7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	312,235,655	385,716,554
57	7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH		
58	7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
59	7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale		
60	7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
61	7206	Financim I pritshe nga buxheti	14,578,178	14,739,141
62	7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)	20,000	1,697,692
63	7209	Te tjera grante korente te brendshme	1,401,591	
64	721	2.Grant korent I Huaj	0	0
65		Nga Qeveri te Huaja		
66		Nga Organizata Nderkombetare		
67		VI.TE ARDHURA TE TJERA	0	0
68	781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
69	782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatshkurtra		
70	783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata		
71	784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme		
72	787	Terheqe nga seksioni I investimeve		
73	73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE		
74	B	SHPENZIMET	296,500,005	391,545,209
75	600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	132,060,145	137,021,140
76	6001	Paga, personel I perhershem	132,060,145	136,657,202
77	6002	Paga personel I Perkohshem	0	363,938
78	6003	Shperblime	0	
79	6009	Shpenzime te tjera per personelin	0	
80	601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	20,515,979	23,605,699
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	18,308,904	21,098,860
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	2,207,075	2,506,839
83	602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	31,055,627	54,218,398
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera		
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	2,585,419	2,414,100
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	4,195,086	7,028,569
87	6022	Sherbime nga te trete	9,422,573	13,112,942
88	6023	Shpenzime transporti	6,292,774	12,344,174
89	6024	Shpenzime udhetimi	1,386,340	688,185
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	1,070,600	1,626,139
91	6026	Shpenzime per qeramarrje	42,500	30,600
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	1,732,143	12,322,813
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		
94	6029	Shpenzime te tjera operative	4,328,192	4,650,876
95	603	IV.SUBVECIONE	2,000,000	5,500,000
96	6030	Subvecione per diference cmimi	2,000,000	5,500,000
97	6031	Subvecione per te nxitur punesimin		
98	6032	Subvecione per te mbuluar humbjet		
99	6033	Subvecione per sipermarrjet individuale		
100	6039	Subvecione te tjera		
101		V.TRANSFERIME KORENTE	113,608,001	128,320,651
102	604	1.Transferime korente te brendshme	5,552,702	8,142,043



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE
USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

103	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise		
104	6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
105	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetesore		
106	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse	5,552,702	8,142,043
107	605	2.Transferime korente me jashte	0	0
108	6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare		
109	6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
110	6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurse te huaja		
111	6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
112	606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	108,055,299	120,178,608
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	108,055,299	120,178,608
115		VL.SHPENZIME FINANCIARE	0	0
116	65	1.Shpenzime Financiare te brendshme	0	0
117	650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
118	651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme		
119	652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
120	656	Shpenz.nga kembimet valutore		0
121	66	2.Shpenzime Financiare te jashtme	0	0
122	660	Interesa per huamarrje nga Qeveri.te Huaja		
123	661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb		
124	662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme		
125		VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA	0	0
126	681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
127	682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		
128	683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit		
129	686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare		
130	63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	-2,739,747	
131		IX.SHPENZIME TE TJERA		42,879,321
132	85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES <i>(Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)</i>	55,823,673	65,075,502

Për të Ardhurat

Sipas kësaj pasqyre paraqiten llogaritë financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2018 (grant) në shumën 328,235,424 lekë nga të cilat grant 312,235,655 lekë , sponsorizime nga të tretët 20,000 , të tjera grante të brendshme 1,401,591 dhe financim I pritshëm nga buxheti 14,578,178 lekë. Të ardhurat e realizuara nga kjo Njësi vendore në vlerën 24,088,254 lekë nga të cilat: të ardhura tatimore në vlerën 10,608,844 lekë dhe të ardhura jotatimore në vlerën 13,479,410 lekë, sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Puke..Gjendja e seciles llogari te te ardhurave rakordon me vlerat e paraqitura ne llogarite analitike te aktit te rakordimit me degen e thesarit Puke.

Po kështu shumat e paraqitura në gjendjet e llogarive të shpenzimeve sipas natyrës të këtij formati rakordojnë me shumat e rezultuara në llogaritë e shpenzimeve sipas klasifikimit buxhetor në aktrakordimin e me degën e thesarit.

Pesha specifike e këtyre shpenzimeve të pasqyruara në këtë format si: Shpenzimet në llog. (600) “Paga, shpërblime e të tjera personeli” në vlerën 132.060.145 lekë zënë 44.1 % të totalit të shpenzimeve; Shpenzimet në llog. (601) “Kontribute të sig. Shoqërore e shëndetësore” në vlerën 20.515.979 lekë zënë 6.9 % të totalit të shpenzimeve; shpenzimet në llog. (602) “Mallra shërbime të tjera” në vlerën 31,055,627 lekë zënë 10.3 % të totalit të shpenzimeve; Shpenzimet në llog. (604) “Transferime korrente te brendshme” në vlerën 5.552.702 zënë 1.9 % të totalit të shpenzimeve në të cilën përfshihen shpenzimet per transfertat për klubin e futbollit , Shpenzimet në llog. (606) “Transferta për buxhete familjare e individë” në vlerën 108.055.299 lekë zënë 36.2 % të totalit të shpenzimeve, në të cilën përfshihen transferta për ndihmën ekonomike dhe për invaliditetin,



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE
USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

Shpenzimet në llog. 603 “Subvencionet” janë me vlerë 2,00,000 lekë dhe zënë 0.6 % të totalit të shpenzimeve.

Per vitin 2017 totali i te ardhurave ne vlere eshte 456.620.711 lek dhe totali shpenzimeve eshte 391.545.209 lek. Diferenca e tyre **ne vleren 65.075.502 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatin e ushtrimit”**

Po kështu **per vitin 2018** totali i te ardhurave eshte 352,323,678 lekë dhe totali i shpenzimeve eshte 299,239,752 lekë Diferenca e tyre **ne vleren 55,823,673 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatin e ushtrimit”** (përfshirë ndryshimi I gjendjeve të inventarit – 2,739,747).

Gjithashtu gjendja e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2017 është në vlerën 5.219.174 lekë dhe për vitin 2018 është në vlerën -2.739.747 lekë.

Formati nr.6 “Investimet dhe burimet e financimit”

- Zeri "Burimet për investime" Formati 6, i plotësuar për shumën 74.955.102 lekë në analizë tregon burimet e investimit, vlera prej 16.371.146 lekë fonde të akorduara nga qeveria për investime, vlera prej 7.854.175 lekë investime të financuara nga buxheti i Bashkisë i caktuar për investime, vlera prej 8.516.971 lekë grante ne natyre (mjete nga Zyra Arsimore dhe automjeti zjarrfikes nga Drejtoria e Policise).

Nr. reshti	Nr Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Teprica ne Fillim te Vitit	Transaksionet e vitit		Teprica ne Fund
				Debi	Kredi	
a	b	c	d	e	f	g
1	I.	SHPENZIMET PER INVESTIME	289,528,500	74,955,102	8,410,481	356,073,121
2	230	Shpenzime per Aktive Afatgjata jo materiale				0
3	231	Shpenzime per Aktive Afatgjata materiale	289,528,500	74,955,102	8,410,481	356,073,121
4	25,26	Shpenzime per Aktive Afatgjata Financiare	0	0	0	0
5	25	Huadhenie dhe nenhuadhenie		0	0	0
6	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet				0
7	II.	BURIMET PER INVESTIME	289,528,500	16,371,146	147,991,269	421,148,623
8	105	1.Grante te brendshme kapitale	289,528,500	16,371,146	82,915,767	356,073,121
9	1050	Grante kapitale nga Buxheti	144,753,712	7,854,175	50,738,114	187,637,651
10	1051	Grante kapitale nga nivele te tjera	144,774,788	0	23,660,682	168,435,470
11	1052	Kontribute te te treteveper investime	0			0
12	1059	Grante te brendshme kapitale ne natyre	0	8,516,971	8,516,971	0
13	106	2.Grante te huaja Kapitale	523,968	0	0	523,968
14	1060	Nga qeveri te huaja	523,968	0	0	523,968
15	1061	Nga institucione nderkombetare	0	0	0	0
16	1069	Grante te huaja ne natyre	0			0
17	14	3.Grante kapitale per investime per te trete	0	0	0	0
18	145	Grante brendsh. kapitale per pjesm. ne invest. ne te trete	0	0	0	0
19	146	Grante te huaja kapitale per pjesm. ne invest. ne te trete	0	0	0	0
20	11	4.Fonde te tjera te veta.	0	0	0	0
21	111	Fonde rezerve	0	0	0	0
22	115	Caktim fondi per investime nga rezultati I vitit		0	0	0
23	116	Te ardhura nga Shitja e aktiveve te qendrushme	0	0	0	0
24	12	5.Rezultati I Mbartur			65,075,502	65,075,502



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

Nga Bashkia Pukë janë kryer investime me burim financimi nga fondet e siguruar nga të ardhurat e veta dhe nga fondet e alokuara nga FZHR. Në analizë këto investime paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Emri i Furnitorit	Data e kontratës	Emri i kontratës	Shuma totale e kontratës	Shuma e paguar deri 30/12/.2018	Shuma e papaguar deri 31/12/18.	Data origjinale e fatures
B. SHPK	94/3 dt 10.12.2013		6,432,000	6,207,000	225,000	09.01.2014
Shoqeria "A.-I. G."shpk	08.06.2011	"Rikkonst Rr Kabash"	71,335,752		8,544,720	08.04.2014
Shoqeria "A.-I. G."shpk	08.06.2011	"Rikons Rruga Lumzi"	95,229,384		7,518,720	08.04.2014
"K." Shpk	14.07.2011	Tunel vadites Dom	32,083,091	31,399,424	683,667	9.12.2013
"K." Shpk	29.08.2012	Rik Shkolla Mesme 8-Dhjetori Qelez	27,959,180	27,670,401	288,779	03.07.2013
K. shpk	05.09.2012	Rik shk Mesme amb Sp Gjegjan	28,544,237	28,361,841	182,396	11.10.2013
D. I.	30.11.2017	Rik Rruga Auto Lumzi	11,368,800	11,303,520	65,280	30.11.2017
		Shuma INVESTIME	272,952,444	73,542,762	17,508,562	

Konkluzion: Nga auditimi i kontratave të lidhura nga bashkia Pukë për investime të pambyllura me likuidim rezultoi se nuk është kryer **kontabilizimi i veprimeve ekonomike për vlerë të plotë të kontratës, as në momentin e mbërritjes së faturave**. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur ndërhyjnë pagesa. Kështu **nuk janë bërë regjistrimet kontabël në llog.231 “Shpenzime për investime për aktive afatgjata materiale” për vlerën 272,952,444 lekë të financuara nga të ardhurat dhe nga FZHR**, pra nuk janë kryer në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime.

Për këto investime nuk janë kryer veprimet kontabël sipa fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike, kështu:

Me celjen e fondeve mbritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve duhej kryer veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llog. 520 “Disponibilitete në thesar” në kredi të llog. 476 “Të ardhura të caktuara për t'u përdorur”.

Me konstatimin e shpenzimit (mbërritja e fatures shoqëruar me situacion) duhej bërë veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, në kredi të llogarisë 404 “Furnitor për investime”.

Në momentin e pagesave të faturave duhej kryer kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “Furnitorë për investime” dhe në kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”.

Në fund të vitit ushtrimor për fondet e përdorura për **investimet në proces** të pa përfundura duhej kryer veprimi kontabël në debi të llog.476 “Të ardhura të caktuara për t'u përdorur” në kredi të llog. 720 “Grant korrent i brendshëm” dhe në kredi të llog. 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

Me përfundimin e investimit të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës është bërë kapitalizimi aktivitet (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhej prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “Aktive afatgjata materiale” në kredi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.

Me kapitalizimin e aktivitet (për aktivitet e marra në dorëzim) duheshin kryer veprimet kontabël:

- në debi të llogarisë 476 “te ardhura të caktuara për t’u përdorur” në kredi llog. 105 “Grante të brendshme kapitale” për fondet buxhetore të përdorura për investime” dhe

- në kredi të llogarisë 1011 “Shtesa të fondit baze” në debi të llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për vlerën e aktiveve të blera.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32,

Në **Kreun I** “Të përgjithshme” në **pikën 8** përcakton: “Metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave në sektorin publik ka të bëjë me:- Njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës”, në **Kreun II** “parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” në **pikën 18/a** përcaktohet: “Për realizimin dhe njohjen e investimeve bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:- Debitohet llogaria përkatëse e investimeve (grupi 23); dhe- Kreditohet llogaria përkatëse e detyrimeve (klasa 4)”, në **Kreun III** “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” në **pikën 32** përcakton: “**Kërkesat për arkëtim mbi debitorët, si dhe detyrimet të paraqiten në pasqyrat financiare me vlerën e evidentuar në kohën e lindjes së të drejtës dhe detyrimit.** Në zbatim të nenit 61 të ligjit të buxhetit, lidhur me njohjen e të ardhurave dhe shpenzimeve në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të drejtat dhe detyrimet, në fund të periudhës raportuese duhet të paraqiten në kontabilitet, si më poshtë:

- **Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre**, ndërsa si të ardhura të njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogaritë financiare, duke mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti”), të cilat evidentojnë të drejtat të njësive të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”).

- **Detyrimet të evidentohen në pasqyrat financiare, duke mbajtur parasysh njohjen në çastin e ndodhjes si shpenzime, pavarësisht nga data e pagesës së tyre nga llogaritë financiare.** Në këtë rast, duhet të mbahet nën kontroll evidentimi joreal i detyrimeve në marrëdhëniet e shtetit me njësitë e qeverisjes së përgjithshme (llogaria 4341, “Operacione me shtetin (detyrime)”).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

2. Titulli i gjetjes: KLSH ka konstatuar se nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura për kryerje investimesh për vlerë të plotë të kontratës, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur ndërhyr pagesa. Kështu nuk janë bërë regjistrimet kontabël në llog.231 “Shpenzime për investime për aktive afatgjata materiale” për 7 kontrata në vlerën 272,952,444lekë të financuara nga të ardhurat dhe nga FZHR, pra nuk janë kryer në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime.

Situata:

Nga testimi i kontratave të investimeve rezultoi se: për 7kontrata në vlerën **272,952,444lekë** të financuara nga të ardhurat dhe nga FZHR, kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura për blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e pagesave për fatura të mbërritura. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve të tjera ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, pra as në momentin e mbërritjes së faturës dhe as të celjes së fondeve. Pra regjistrimet kontabël janë kryer në momentin e kur është kryer pagesa dhe jo në kohën e lindjes të një detyrimi për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime. Ky konstatim vlen për të gjitha rastet e lidhjes së kontratave me të tretët, të cilat nuk janë evidentuar në kontabilitet në vlerë të plotë,duke mos paraqitur vlerën e plotë të detyrimeve të lindura nga angazhimet financiare të krijuara nga lidhja e kontratave me të tretët.

Kriteri

Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”Kapitulli I,pika 1. me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32.

Impakti

Mospasqyrimi në kontabilitet në vlerë të plotë të kontratave të lidhura për mallra dhe shërbime ka ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me detyrimet e lindura të konstatuara, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku

Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për mbajtjen e evidencës kontabël në përputhje me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Rëndësia:

- I lartë.



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

Rekomandimi Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Pukë të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin e nënshkrimit të tyre, duke pasqyruar të gjitha detyrimet financiare të lindura nga angazhimi i krijuar nga lidhja e kontratave të lidhura dhe jo thjesht kur ndërhyr pagesa, pasi videntimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve është i domosdoshëm për njohjen reale të borxhit të akumuluar dhe marrjen e masave për zvogëlimin gradual të tij.

Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” kapitulli III, pika 30., me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32., me UMF nr. nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 28.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi znj.F. P. me detyrë Drejtore Ekonomike e Buxhetit dhe Ndihmës Ekonomike, në cilësinë e nëpunësit zbatues (NZ), dhe hartueses së pasqyrave financiare.

V. KONKLUSIONE DHE OPINIONI AUDITIMIT

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi auditimin financiar (Pasqyrave financiare viti 2018)

Baza per opinionin

Ne kemi kryer auditimin financiar mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014, datë 24.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit.

Sipas këtyre standardeve, përgjegjësia e Auditit të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar.

Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga Njësia e Qeverisjes Vendore Bashkia Pukë dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Pukë për vitin ushtrimor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrat: pozicionit financiar, e përfomancës financiare, e cash-floë (hyrjeve dhe daljeve (pagesave) në para), e amortizimit, fondeve neto, e investimeve dhe burimet e financimit, e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata, dhe e shënimeve shpjeguese



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

që shoqëronin këto pasqyra. Auditimi ka pëfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave, që nuk kanë ndikim të dukshëm mbi nivelin e materialitetit prej 2% si prag të marrë në konsideratë dhe në vendim-marrjen e përdoruesve të pasqyrave financiare.

Kemi konstatuar se në disa llogari të pasqyrave financiare, janë kryer veprime kontabël të gabuara duke denaturuar përmbajtjen e tyre dhe duke pakësuar vlerat kontabile, çka i bëjnë ato të pasakta:

- Nga verifikimi i inventarëve kontabël rezultoi se janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur

- Për vitin ushtrimor 2018 nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura për blerje mallrash apo projekte investimesh për vlerë të plotë të kontratës, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur ndërhyjnë pagesa. Kështu nuk janë bërë regjistrimet kontabël në llog.231 “Shpenzime për investime për aktive afatgjata materiale” për 7 kontrata në vlerën 272,952,444 lekë lekë të financuara nga FZHR, pra nuk janë kryer në kohën e lindjes të detyrimit për t’u paguar nga njësi ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime.

Këto veprime nuk përputhen me parimet e kontabilitetit të pranuar, ligjit organik të buxhetit, si kërkesat e: VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” kapitulli III, pika 30., e Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32., me UMF nr. nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 28. Ne besojmë se auditimi ynë ofron baza të arsyeshme për opinionin tonë.

Opinion i kualifikuar.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700 dhe ISSAI 1200 shprehim një opinion të kualifikuar për llogaritë vjetore të Bashkisë Pukë duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në periudhën nën auditim dhe mbi të gjitha, janë të korigjueshme.

Në opinionin tim, Pasqyrat Financiare të Bashkisë Pukë, përveç çështjeve të trajtuara në bazën për kualifikimin e opinionit, paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale,



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

pozicionin financiar në 31 dhjetor 2018, performancën e tij financiare dhe fluksin e parasë për vitin respektiv në përputhje me Kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

Përgjegjësi e Drejtuesve të Bashkisë Pukë

Drejtimi i bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe të Udhëzimit të MFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuar. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e audituesve të KLSH

Objekivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkaktë pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë

Ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) ta klasës 21 për vitin 2017 është në vlerën 3.356.915.085 lekë dhe për vitin 2018 është në vlerën 3.766.275.808 lekë, e cila është paraqitur e plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. **Inventari kontabël i aktiveve materiale** gjendje në llogaritë: **210 “Toka, Troje, Terrene”** është në vlerën 1,202,645 lekë; **211 “Pyje, Plantacione”** në vlerën 15,700,355 lekë, **212 “Ndërtesa Konstruksiione”** në vlerën 561,791,720 lekë; **213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** në vlerën 740.851,408 lekë; **214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerën 22,475,780 lekë **nuk është i qartë në përcaktimet e emertesave dhe vlerave të**



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

secilit aktiv artikull për artikull, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktivi, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve të secilit aktiv. Në këto inventare janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas amërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.

Inventari fizik është kryer vetëm për aktivet e llogarive: **215 “Mjete Transporti”** në vlerën 24,649,367 lekë; **218 “Inventar Ekonomik”** në vlerën 70,834,942 lekë; **31 “Materiale”** në vlerën 13,249,117 lekë; **32 “Inventari i imet”** në vlerën 14.321.569 lekë lekë, i cili rakordon me inventarin kontabël. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” Kapitulli I, pika 1. me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32.

1.1 Për këtë rekomandojmë: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Pukë të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktivesh sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

Brenda datës 31.12.2019

2. Gjetja nga auditimi: Nga testimi i kontratave të investimeve rezultoi se: për 7 kontrata në vlerën **272,952,444lekë** të financuara nga të ardhurat dhe nga FZHR, kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura për blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e pagesave për fatura të mbërritura. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve të tjera ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, pra as në momentin e mbërritjes së faturës dhe as të celjes së fondeve. Pra regjistrimet kontabël janë kryer në momentin e kur është kryer pagesa dhe jo në kohën e lindjes të një detyrimi për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime. Ky konstatim vlen për të gjitha rastet e lidhjes së kontratave me të tretët, të cilat nuk janë evidentuar në kontabilitet në vlerë të plotë, duke mos paraqitur vlerën e plotë të detyrimeve të lindura nga angazhimet financiare të krijuara nga lidhja e kontratave me të tretët.

2.1.Për këtë rekomandojmë: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Pukë të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin e nënshkrimit të tyre, duke pasqyruar të gjitha detyrimet financiare të lindura nga angazhimi i krijuar nga lidhja e kontratave të lidhura dhe jo thjesht kur ndërhyjnë pagesa, pasi videntimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve është i domosdoshëm për njohjen reale të borxhit të akumuluar dhe marrjen e masave për zvogëlimin gradual të tij.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2018, u konstatua se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

a. Mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas produkteve dhe qendrave të kostos për shpenzimet dhe planifikim jo mbi baza reale të të ardhurave, të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përlogarisin saktë nevojat për planifikim, por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojnë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj.

b. Buxheti për vitin 2018 paraqitet me një performancë jo të kënaqshme në lidhje me nivelin mesatar të realizimit të fondeve në masën 84 %, ku ka ndikuar realizimi në nivel të ulët të shpenzimeve operative në masën 59% dhe investimeve në masën 67%, ndërkohë që në datë 31.12.2018 detyrimet e papaguara janë në nivel të lartë në shumën 43,682,262 lekë ose në masën 10% të shpenzimeve totale të planifikuara.

c. Kryetari i Bashkisë për vitin 2018 janë përgatitur raporte 4-mujore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe krahasimi i tyre me planifikimin e buxhetit për cdo zë të tij sipa programeve të funksioni të kësaj njësie vendore, duke e paraqitur në Këshillin e Bashkisë. Këto raporte monitorimi janë raportuar vetëm në tregues tregues sasiore pa analizuar dhe shkaqet dhe përcaktuar masat korrigjuese për përmirësimin e situatës.

3.1. Për këtë rekomandojmë a. Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e buxhetit, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përlogaritjes së kostos së aktiviteteve në bazë produktesh për cdo program me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve nga këto objektiva. Procesi i planifikimit të buxhetit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike si dhe përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit të vitit koherent në arritjen e objektivave. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve dhe të sigurojë një përdorim eficient të burimeve financiare, si dhe të ruajë stabilitetin makroekonomik e fiskal.

b. Nevojitet të gjurmohet saktë dhe drejtë konsumimi i burimeve të nevojshme, duke synuar shpërndarjen e shpenzimeve (kostove) sipas aktiviteteve që i “shkaktojnë” këto kosto, me qëllim ndjekjen e kujdesshme të kostove për efekte buxhetore duke synuar minimizimin e rishpërndarjeve mes zërave buxhetore brenda vitit ushtrimor. Të rritet performanca e realizimit të buxhetit në nivel të kënaqshëm si për të të ardhurat në bazë reale dhe për shpenzimet në termat e produkteve, si dhe të merren angazhime për të marrë veprimet e duhura korrigjuese për të përmirësuar situatën dhe aty ku është e nevojshme të ndërhyhet.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se janë kryer pagesa me urdhër-shpenzime në 40 raste në vlerën 23,280,452 lekë mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime dhe investime të mbërritura në institucion, ku një pjesë janë për shkak të kufizimit të limitit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

të arkës nga MFE për pagesat e vitit 2017 me shkresën nr.15973 datë 09.11.2017 dhe për pagesat e vitit 2018 me shkresën nr.19932 datë 07.11.2018.

4.1. Për këtë rekomandojmë Bashkia Pukë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos ketë kufizime limiti të arkës për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikujduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Perfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT TË KLSH

I. Sh.

G. Sh.

Sh. H.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TE
USHTRUAR NË “BASHKINË PUKË”

PASQYRAT ANEKS QË SHOQËROJNË
PROJEKTRAPORTINE AUDITIMIT
NË
SUBJEKTIN BASHKIA PUKË
ANEKSE

ANEKSI I:

OASIA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet, niveli i precizionit pranohet në vlerën 7,195 mijë lekë për vitin 2018 për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan: - teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli); Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë: - Risku i lidhur me shpenzimin specifik; - Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Çështje për t'u shqyrtuar = (Artikulli buxhetor : Precizoni x Faktor risku)

Niveli i materialitetit për vitin 2018, është përllogaritur sipas tabelave të mëposhtme:

Bashkia Puke				
Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar	
Paga (600)	139.657	0,70	14	
Sigurime Shoqërore (601)	23.362	0,70	2	
Mallra e Shërbime (602)	53.104	0,70	5	
Investime të brend. (230-231)	111.315	2,00	31	
Te tjera transfer. korrente (603-606)	116.700	0,70	11	
Total	444.138			
<i>Materialiteti në %</i>	2%			
Materialiteti në vlerë	8.883			
<i>Kalkulimi i precizionit</i>				
Materialiteti	8.883			
<i>Gabimi i lejuar (10% - 20%)</i>	888			
Nëntotali	7.994			
<i>Precizioni i planifikuar (80-90%)</i>	90%			
Vlera e precizionit	7.195			
Bashkia Puke				
Emërtimi i të ardhurave	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar	
Të ardhurat nga buxheti	260.894	0,70	37	
Të ardhurat e veta	44.000	0,70	6	
Total	304.894			
<i>Materialiteti në %</i>	2%			
Materialiteti	6.098			
<i>Kalkulimi i precizionit</i>				
Materialiteti	6.098			
<i>Gabimi i lejuar (10%-20%)</i>	610			
Nëntotali	5.488			
<i>Precizioni i planifikuar (80 -90%)</i>	90%			
Vlera e precizionit	4.939			